



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

RELACION MKZ

OBJEKTI: "Rikonstruksion i oficines (studim-projektim)

VENDODHJA: Rruga 5 Maji, Tirane, Shqiperi



SHTATOR 2024

1.1 SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

1.1.1 Të përgjithshme

Projekti “Rikonstruksion i oficines (studim-projektim)”

Projekti i mbrojtjes kundër zjarrit është projektuar në përputhje me strukturimet arkitektonike dhe konstruktive të godines si dhe dy nga kriteret projektuese të mbrojtjes kunder zjarrit, që janë Mbrojtja passive dhe Mbrojtja Aktive

Mbrojtja pasive:

Meqenëse kemi të bëjme me një objekt ekzistues , zgjidhjes arkitektonike dhe konstruktive duhet ti përshtaten masat e mbrojtjes passive kunder zjarrit sic janë: Gjatësitë dhe gjerësitë e korridoreve, mbrojtja e rrugëve të evakuimit, dhe daljeve të emergjences, përcaktimit i materialeve të strukturave të magazinës të cilat vleresohen në baze të rezistencës që ato paraqisin karshi zjarrit. Ne kete seksion si pjese e hartimit të projektit të impiantit te mbrojtjes kundra zjarrit do te trajtohet më gjërësisht pjesa e mbrojtjes aktive të sistemit.

Mbrojtja aktive:

Ka të bejë me zgjidhjen projektuese të impianteve dhe mjeteve të shuarjes së zjarrit me paisjet portative si: fikset me pluhur, me gaz dhe me shkume. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit eshte realizuar ne baze te disa normave dhe standarte . Ky sistem mbështetet në ;

Normat, rregulloren si dhe kriteret projektuese te vendeve te Komunitetit Europian si dhe përputhjet me rregulloret ePMNZSH –së ne Shqiperi. Norma UNI 9490 per “Pajisjet e shuarjes se zjarrit dhe rezerva ujore per impiantet automatike te mbrojtjes nga zjarri”. Kjo norme percakton qarte komponentet qe duhet te kete. Impianti i Mbrojtjes Kundra Zjarrit, percakton rezerven ujore, te jete e akumuluar ne rezervuar fiks te pashtershem, te jete e paster pa permbajtje algash, materiale korrozive apo materiale te tjera suspance, te jete e paprekshem ne cfaredolloj rasti.

Ligji Nr. 8766, datë 5 .4.2001 (Ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 nr. 11/2013, date 14.2.2013) I ndryshuar përsëri nga udhëzimi 425 dt 24.07.2015)

“PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN . Ky ligj percakton qarte strukturen dhe veprimtarine e PMNZSH-se ne rast zjarri si dhe menyren e mbrojtjes se objekteve nga ana e ketij personeli; gadishmerine dhe masat parandaluese e mbrojtese qe duhet te ndermari personeli ne rast zjarri.

- Ligji nr 152/2015 PËR “MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË KONSTRUKSIONET DHE NDËRTIMET, QË SHËRBEJNË PËR VEPRIMTARI AKOMODUESE TURISTIKE”

1.1.2 Klasifikimi i zjarreve

Per te perdorur agjente shuare te pershtatshem gjate procesit te mbrojtjes nga zjarri, ne funksion te Materialeve qe mund te marrin flake, jane marre ne konsiderate klasat e zjarrit. Ne baze te normave/standarteve bashkekohore, pajisjet shuarese te zjarrit jane klasifikuar ne pese klasa. Standarti europian CNVVF/CPAI UNI 9485 per keta shuarsa dallon klasat e meposhtme:

Klasa A . Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te ngurte sikurse derrase, leter, plastik, tekstile, etj.

KlasaB. Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te lengshem sikurse benzene, benzole, nafte, alkol, vajra etj.

KlasaC. Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te gazte sikurse metan , propan , butan GPL etj.

Klasa D . Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etc.

KlasaE. Perdoret per pajisje elektrike qe jane nen tension.

Ne projekt jane percaktuar me saktesi zonat sipas te klasit te zjarrit dhe ne përputhje me to jane zgjedhur lloji i fikseve portative (bombolave) si dhe hidrantet e zjarrit.

Në rastin konkret objekti jonë klasifikohet në Klasën A dhe E për përdorim të paisjeve të shuarjes së zjarrit , mëqënëse zjarri që mund të bjerë e ka origjinën nga materialet e ngurta si leter, plastic etj , si dhe nga paisjet elektrike që janë nën tension.

1.1.3 Substancat shuarese te zjarrit

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e ndertes si dhe aktivitetet qe zhvillohen, do te perdoren substanca shuarese si me poshte:

- Pluhur

1.1.4 Pajisjet e shuarjes se zjarrit

Pajisjet e levizshem te shuarjes se zjarrit

· Bombola portative dhe karelato (shkume, pluhur, gaz) (aplikohen ne te gjithe godinen)

1.1.5 Kriete te pergjithshme projektuese

Relacion MKZ

Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit eshte konceptuar ne perputhje me kerkesat dhe normat e pajisjeve shuarse qe do te aplikohen.

Faktoret percaktues qe jane marre ne konsiderate gjate projektimit jane :

- Natyra dhe permasa e zjarrit;
- Madhesia e zones qe do te mbrohet;
- Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;
- Kerkesat dhe normat sipas CNVVF/CPAI UNI 9485 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

1.1.6 Fikset e zjarrit

Sipas klasifikimit te mesiper te mjeteve te shuarjes se zjarrit me poshte po shtjellojme kerkesat kryesore per fikset portative:

Fikset me pluhur jane pajisje qe perdoren ne rast zjarri, te cilet zakonisht jane te adoptuar per te gjitha tipet e zjarrit-kjo shpjegon edhe arsyen se perse keto pajisje i gjejmë pothuajse ne çdo ambient. Pluhuri është një material solid i ngjashëm me pudrën. Numri dhe dimensionimi i cilindrave per shuarjen e zjarreve eshte percaktuar ne perputhje me normat / standartet ekzistuese.

Gazi halogjen eshte nje sistem i perdorur per te fikur zjarrin ne raste apo ne pajisje specifike, aty ku kerkohet nje agjent elektrik joproductive ne te cilen agjente te tjeres shuares krijojne probleme, ku kapacitetet shuarse me peshe te vogel jane nje faktor i rendesishem ne percaktimin e llojit te shuaresit.

Ky gas ka specifika e tij dhe funksionon me se miri me gazin tradicional halon 1301, i cili arrin piken e vlimit ne temperaturen -16.4 °C.

Eshte nje gas i super presurizuar (25–42 bar) ne menyre qe te arrije sa me shpejt te mbushe hapesiren te cilen mbron. Ky gaz eshte i ruajtur ne bombola sipas peshes pecifike.

1.1.7 Sinjalistika e sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit:

Nje element shume i rendesishem ne mbrojtjen kundra zjarrit eshte vendosja e sinjalistikes perkatese.

Kjo perbehet nga nje numer i madh tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si p.sh.

- Tabela paralajmëruese - jane tabelat qe tregojne ndalimin e ndezjes se zjarreve, ndalimit te perdorimit te ujit per shuarje etj.

- Tabela treguese – sic jane drejtimet e daljes, vendosja e bombolave etj.

Te gjitha keto elemente jane paraqitur ne projekt me specifikimet perkatese. Shembujt e mesiperm te sinjalistikave jane te shumta por ne projekt jane përcaktuar rigorozisht te gjitha llojet e sinjalistikave te nevojshme sipas kriterëve te përcaktuara nga normativat perkatese. Ato parashikohen ne dimensionet dhe ne materialet perkatese dhe ne vendet e duhura.

Emri I objektit:
"Rikonstruksion i oficines (studim-projektim)
Vendndodhja:
<u>Rruga 5 Maji, Tirane</u>
Investitor:
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT
Siperfaqja e pergjithshme e objektit/aktivitetit/lartesia/numri I kateve:
398 m ² - siperfaqja totale
<u>5.6 m - lartesia e katit</u>
<u>1- numri I kateve</u>

Mjetet per fikjen e e zjarreve:
Instalime te fiksuar per mbrojtjen nga zjarri:
Impiant per fikjen automatike te zjarreve (tip sprinkler):
<u>Nuk ka</u>
Impiant hidrik antizjarr ne objekt/aktivitet (diametri I hidrantit te instaluar):
<u>Jane vendosur 0 hidrante te brendshem</u>
Impiant I fikseve te levizshme (numri ne total I fikseve te zjarrit):
Ne kapanon jane vendosur 10 fikese me pluhur me peshe 6kg me tip <u>55A 233BC</u> .
Numri I kateve dhe destinacioni I tyre:
Mbi toke: <u>1 kat</u>
Numri I hyrje/daljeve vertikale :
<u>1</u>
Qendrueshmeria nga zjarri: <u>5-6 minuta</u>

Pergatiti:

"2H- Construction " shpk Nr .lic. N- 7023/1